
MEMORANDUM MIRËKUPtimi NDËRMJET ORGANIZATËS BOTËRORE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE TË SHQIPËRISË

Organizata Botërore e Pronësisë Intellektuale (WIPO) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markava (DPPM), (këtu e më poshtë referuar si “Palët”);

Duke marrë në konsideratë që mandati i WIPO-s është që të promovojë mbrojtjen e pronësisë intelektuale (PI) nëpër botë dhe që zhvillimi i bashkëpunimit në fushën e pronësisë intelektuale është një ndër rrugët në të cilën WIPO po kryen këtë mandat;

Duke marrë në konsideratë që një ndër prioritet kryesore të DPPM-së është që të zhvillojë sistemin e pronësisë industriale në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të administrimit dhe mbrojtjes ligjore të të drejtave të pronësisë industriale, duke zhvilluar sistemin e mbrojtjes të pronësisë industriale në Shqipëri, duke hartuar strategji për PI, duke zhvilluar politika dhe praktika moderne, promovimin e aktiviteteve të inovacionit, duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e pronës industriale, duke zhvilluar aftësi profesionale nëpërmjet krijimit të institucionit të edukimit për Pronësinë Intellektuale (PI) dhe duke shkëmbyer informacione dhe duke zhvilluar infrastrukturë globale për pronësinë industriale, duke përfshirë bazë të dhënash(database) për PI.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë thelbësore të bashkëpunimit për zhvillimin e një sistemi efektiv për mbrojtjen e pronësisë industriale;

Duke qenë të vetëdijshëm për përfitimet që mund të përfitohen nga bashkëpunimi më i ngushtë ndërmjet Palëve në nxitjen e aktiviteteve në fushën e pronësisë industriale, dhe

Duke patur dëshirën për të nxitur bashkëpunimin midis WIPO-s dhe DPPM-së, në mbështetje të qëllimeve të tyre të përbashkëta në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale;

Kanë rënë dakort sa më poshtë:

NENI 1

Palët do të bashkëpunojnë në kërkime, mësimdhënie dhe në ndërtimin e kapacitetit të burimeve njerëzore në fushën e mbrojtjes të pronësisë industriale në Shqipëri, duke përfshirë themelimin e insitucionit edukues për pronësinë industriale në Shqipëri, nëpërmjet bashkëpunimit me DPPM-në që synon në përmirësimin e administrimit të zyrës, zhvillimin e burimeve njerëzore, ekzaminimin e patentave dhe markave dhe mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të pronësisë industriale, në mënyrë që të nxitet ndërgjegjësimit më i madh për PI dhe ndërtimin e kapaciteteve, për të drejtuar zhvillimin e profesionistëve të aftë të PI për të mbështetur komunitetet e kërkimit dhe të biznesit, për të ofruar një gamë të gjerë dhe multidisiplinare të mundësive të vazhdueshme të edukimit dhe trajnimit për profesionistët e PI-së, organizatat e biznesit, institucionet e kërkimit, stafin e DPPM-së dhe krijues dhe përdorues të tjerë të PI-së. WIPO do të asistojë DPPM-në në zhvillimin e infrastrukturës, kryesisht në hartimin e programeve të trajnimit, sigurimin e platformave për të mësuar në distancë dhe organizimin e kurseve të përbashkëta.

NENI 2

Palët, nëpërmjet një procesi konsultimi me aktorët kryesore të sistemit të pronësisë intelektuale, do të bashkëpunojnë në formulimin e një strategjie kombëtare për pronësinë intelektuale për Shqipërinë, për të përdorur në mënyrë efektive sistemin e pronësisë intelektuale për përmbushjen e qëllimeve të zhvillimit kombëtar.

NENI 3

Palët, së bashku, do të marrin në konsideratë organizimin e simpoziumeve, seminareve, takimeve dhe programeve të tjera të trajnimit në Shqipëri, rregullisht.

NENI 4

Palët do të bashkëpunojnë në zhvillimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në Shqipëri.

NENI 5

Palët do të bashkëpunojnë në aktivitetet në lidhje me promovimin e inovacionit në Shqipëri.

NENI 6

Termet dhe kushtet konkrete për zbatimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të referuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi (MoU) do të kërkojnë marrëveshje suplementare të cilat do të përcaktojnë përgjegjësitë operacionale dhe financiare të secilës Palë.

NENI 7

MoU do të bëhet efektive me nënshkrimin e Palëve dhe mund të amendohet nëpërmjet miratimit të përbashkët të Palëve, të shprehur me shkrim. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet ose nga WIPO ose nga DPPM, duke dhënë një njoftim me shkrim gjashtë muaj para. Në rast përfundimi, nuk do të ndikohen detyrimet të cilat kanë hyrë në fuqi më parë, nëpërmjet projekteve apo aktiviteteve që janë duke u zbatuar sipas kësaj MoU, me përjashtim nëse është rënë dakort ndryshe.

NENI 8

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet WIPO-s dhe DPPM-së në lidhje me këtë MoU, do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet negociatave të drejtëpërdrejta ndërmjet Palëve.


Në dëshmi të këtij dokumenti, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë MoU.

Bërë në dy kopje, në gjuhët Anglisht dhe Shqip, ku të dyja tekstet janë në mënyrë të barabartë autentike.

Në Tiranë më 04 Mars 2016

**Për Drejtorinë e Përgjithshme të
Patentave dhe Markave**

Z. Elvin Lako
Drejtori Përgjithshëm



**Për Organizatën Botërore të
Pronësisë Intelektuale (WIPO)**

Z. Francis Gurry
Drejtori Përgjithshëm